

**Znj. Vjosa Osmani**

Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Kërkesë**

E nderuara Znj. Osmani,

Jemi shumë të lumtur për progresin në konstituimin e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të tetorit 2019. Meqë kuvendi i ri së shpejti do të formoj komisionet parlamentare, kërkojmë që kjo të bëhet në funksion të rritjes së llogaridhënies së institucioneve, ndarjes së përgjegjësisë, ngritjes së balancit të pushteteve dhe përfaqësimit të barabartë politik dhe gjinor.

Në mënyrë që komisionet parlamentare të iu shërbejnë qëllimeve të lartpërmendura, ju kërkojmë:


1. Të krijohen komisione parlamentare që rrisin në masë të konsiderueshme monitorimin e qeverisë, agjencive dhe institucioneve ekzekutive, pavarësisht numrit dhe ri-strukturimit të tyre. Të ketë komisione të veçanta për sektorë të caktuar sikurse për arsim, shëndetësi, siguri, ambient, kompani publike dhe agjenci të pavarura, dhe të tjera;
2. Me qëllim të fuqizimit, të ngritjes së llogaridhënies dhe balancit të pushteteve duhet garantuar që komisionet për mbikëqyrjen e financave publike, politikës së jashtme, integriteteve evropiane, monitorimin e kompanive publike, agjencive të pavarura dhe atyre ekzekutive, arsimit, shëndetësisë, sigurisë dhe inteligjencës të kryesohen nga opozita;
3. Të angazhoheni për rritjen e përfaqësimit gjinor me rastin e emërimit të kryesuesve dhe nën-kryesuesve të komisioneve parlamentare, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore;
4. Grupit të grave deputete të i jepet status më të fuqizuar.

Këto kërkesa janë në përputhje me raportin e Grupit për Ballkan lidhur me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, i cili do të publikohet së shpejti. Raporti përmban një numër rekomandimesh të rëndësishme të cilat adresojnë drejtpërdrejtë mangësitë e rregullores së tanishme të Kuvendit. Problemet e reja me të cilat përballet secila periudhë legjislative kërkojnë që rregullorja të ndryshohet dhe përshtatet.

Duke ju uruar punë të mbarë, Grupi për Ballkan kërkon bashkëpunimin tuaj në këto intervenime që do të rrisin nivelin e demokracisë në vend përmes përmirësimit të procesit të punës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me nderime,

Në emër të ekipit të Grupit për Ballkan



Naim Rashiti, Drejtor Ekzekutiv

Qamil Hoxha 29/7,

Prishtinë 10000, Kosovë

**office@balkansgroup.org**

+383 38 235 005